

VENDIM
Nr. 879, datë 11.11.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 5, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË
PROCEDURAVE PËR PËRFITIMET NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË
RINDËRTIMIT DHE PROJEKTET MODEL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 19, 20 e 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8, e kreut II, të vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Projekt model konsiderohet edhe:

a) projekti që realizon vetë subjekti, që kërkon përfitimin e grantit, me kusht që të plotësojë kërkesat dhe standardet sipas parimeve të procesit të rindërtimit dhe sipas parashikimeve të këtij vendimi;

b) projekti që realizon vetë subjekti, kur ndërtimi do të realizohet në të njëjtin truall dhe sipërfaqja e truallit nuk lejon realizimin e projektit model, me kusht që të plotësojë kërkesat dhe standardet sipas parimeve të procesit të rindërtimit dhe sipas parashikimeve të këtij vendimi.

Vlera e grantit që përfitohet, edhe në këto raste, përlllogaritet sipas parashikimeve të kreut III, të këtij vendimi, dhe miratohet me vendim të këshillit bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Enti Kombëtar i Banesave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe